



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.404/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e parashtuara nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, Dafina Shehu, të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të Kuvendit Komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 07.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat ZL.Anr.404/2025, ZL.Anr.405/2025, ZL.Anr.406/2025, ZL.Anr.407/2025, ZL.Anr.408/2025, të datës 05.11.2025, të parashtuara nga Dafina Shehu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitura kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, Nr.01/3093-2025, të datës 03.11.2025, për shpalljen e rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 05.11.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e parashtuara nga Dafina Shehu, kandidate për Kuvendin e Komunës së Prizrenit, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ZL.Anr.404/2025, ZL.Anr.405/2025, ZL.Anr.406/2025, ZL.Anr.407/2025, ZL.Anr.408/2025, në të cilat pretendohet se në vendvotimet në Komunën e Prizrenit, me numrat 2005/04, 2075/06, 2010/04, 2028/01, 2001/03, 2023/04, gjatë numërimit të votave, ka pasur parregullsi, ku në kutinë me nr. 2005/04, dhe 2075/06, sipas dëshmisë së vëzhguesit të QKN-së në Prizren duhet të ishin 8 (tetë) vota, pasi që vëzhguesit kishin kuptuar manipulimin e votave në këtë kuti, dhe kinse me janë kthyer votat për mua në sistem nuk figurojnë më shumë se 3 (tri) vota. Në kutinë me nr. 2023/04 në QKN, mungojnë 3 (tri) vota dhe një fletëvotim i është dëmtuar por nuk dihet saktë se ku ka ndodhur shkelja e supozuar në klasë apo në QKN. Në vendvotimin 2023/04, i kanë ngatërruar numrat nga nr. 26 në nr. 29, në vendvotimin ku kanë votuar familjaret e saj. Në fshatin Zojz, në vendvotimin 2028/01, votat e saj nuk kanë dalur edhe pse e kanë votuar. Në kutinë 2001/03, sipas dëshmisë së vëzhguesit

në kutinë 2001/03, sipas dëshmisë së vëzhguesit të Lëvizjes Vetëvendosje, gjatë procesit të numërimit janë parë katër vota në favorin tim, megjithatë, në sistem figurojnë vetëm 3 (tri) vota të regjistruara, andaj duke u bazuar në mospërputhje të votave kërkon që të bëhet rishikimi dhe rinumërimi i votave për këtë klasë/kuti në mënyrë që të sigurohet saktësia dhe transparenca e procesit zgjedhor, si dhe rishikim dhe rinumërim i të gjitha kutive të cekura në ankesë.

Në përgjigje në ankesë të KQZ-së, datë 05.11.2025, wshtw theksuar se, bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr,01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Andaj, bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV.

Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund të korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Më tej në përgjigje theksohet se, sa i përket pretendimeve të palës ankuese, se disa nga familjarët- votues, kanë votuar për të, mirëpo, i mungojnë votat. Ky pretendim nuk mund të vërtetohet, pasi që vota është e fshehtë dhe, në përputhje me parimet e fshehtësisë dhe lirisë së votës, dhe po ashtu në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit.

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese e cila mbështetet në pritshmërinë dhe deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1,3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit.

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante, që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet tij.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor, gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.404/2025, ZL.Anr.405/2025, ZL.Anr.406/2025, ZL.Anr.407/2025, ZL.Anr.408/2025, datë 05.11.2025 të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i

këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët ZL.A.nr.404/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesave dhe shkresave të lëndës vlerëson se:

Ankesat janë të pabazuara.

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjes në ankesë të KQZ-së, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesat e parashtruara nga Dafina Shehu kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit, nga radhët e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), të paraqitura kundër shpalljes së rezultateve përfundimtare të publikuara nga KQZ-së, janë të pabazuara.

Sa i përket pretendimeve të palës ankuese që mbështeten në deklaratat e votuesve dhe deklaratat e vëzhguesve të Subjektit Politik LVV, sipas vlerësimit të panelit janë të pamjaftueshme si provë e vetme të vërtetoj pretendimet e saj për parregullsi, nga se deklaratat e familjarëve si votues të mundshëm të kandidates në fjalë, nuk mund të merret si dëshmi e vlefshme për të mbështetur pohimet e ankueses për parregullsi në lidhje me shpalljen e rezultateve përfundimtare, dëshmia si e tillë nuk e përmbushë as kushtin formal dhe as atë përmbajtësor të konsiderohet provë bindëse për procedim dhe hetim të mëtutjeshëm apo për hapjen e kutive të votimit. Sa i përket konstatimit të vëzhguesve Seid Gashi dhe Zamir Begaj, të cilët kanë konstatuar për një parregullsi në ora 3:05 min. (ashtu siç është konstatuar) Paneli vlerëson se lidhur me këtë parregullsi me reagimin e vëzhguesve votat kanë hyrë në rinumërim sipas këtij konstatimi.

Po ashtu Paneli vlerëson se nenin 4 paragrafi 1.3 të LZP, është paraparë që: “ liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjësi për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim; liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara, gjer sa shpërfaqja e vullnetit të votuesve në parim cenon fshehtësinë e votës.”

Paneli vlerëson se deklaratat e votuesve të cilët pretendojnë se kanë votuar një kandidate të caktuar nuk mund të merren si prova të bazuara për faktin se nuk mund të vërtetohet në asnjë formë se votuesit përkatës të kenë votuar për subjektin e caktuar dhe kandidatin e caktuar për shkak se fletëvotimi nuk mund të identifikohet me emrin e votuesit.

Andaj Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj. Kështu që bazuar në të lartcekurat konkludohet se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesja e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur veprime që janë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë

të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 9 paragrafi 5.17, të Rregullore nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, dhe paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.404/2025, datë 07.11..2025

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.